



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DREJTORIA PËR FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

DATË/A:	07. 05. 2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit
KOPJE :	Zyrës së Kryetarit të Komunës z. Agim BAHTIRI – Kryetar z. Faruk MUJKA - Nënkyetar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik z. Shukri GASHI – Drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për propozim për ndryshim/plotësim të Rregullores nr. 02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale

Të nderuar,

Ju njoftojmë se Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik (DFZHE) në mbledhjen e 11-të të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datën 12.04.2021 ka propozuar para ekzekutivit propozimin për ndryshime në rregulloren nr. 02/2019 për Taksat, tarifat dhe Gjobat Komunale dhe ka kërkuar edhe nga drejtoritë tjera në rast se kanë ndonjë propozim për ndryshim të rregullores në fjalë.

Përpos DFZHE, deklarime për propozime për ndryshime kanë bërë edhe DAP, DMMP dhe DSHPI.

Në ndërkohë në koordinim me ekzekutivin, sekretarinë e kuvendit komunal si dhe me zyrën për informim, sipas procedurave është caktuar data 27.04.2021 si datë e mbajtjes së dëgjimit publik me palët e interesuara/qytetarët sa i përket propozimeve për ndryshime të rregullores së lartcekur.

Më pastaj në mbledhjen e 12-të të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datën 26.04.2021, prap ka qenë si pikë ri-kujtuuese e rendit të ditës çështja e dëgjimit publik.

Me datën 27.04.2021, kur edhe është dashur të mbahet dëgjimi publik, i njeti nuk është mbajtur në mungesë të pjesmarrësve – palëve të interesuara edhe pse ka qenë publikuar në ueb faqën e komunës.

Megjithatë, më poshtë i gjeni propozimet për ndryshime/largim/shtim të taksave, tarifave dhe gjobave komunale:

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (DAP):

Propozimi për plotësim neni 7, tabela numër 1

Tabela nr.1

Pika 1.2 - Regjistrimi i vdekjes me vonesë me Aktvendim LAV pas 30 dite nga 25€ është bërë 50€

Pika 1.4 – lidhja e martesës jashtë orarit të punës brenda institucionit është hjekë nga tabela

Pika 1.11 –Lidhja e martesës në mes të dy qytetarëve të Kosovës është hjekë nga tabela

Pika 1.12 – Lidhja e martesës me një shtetas të huaj është hjekë nga tabela

Ndërsa te tabela pjesa e parë duhet të shtohet:

Ceromonia e lidhjes së martesës në vlerë 5€

Dhe tabela me poshtë duhet te shtohet komplet

Lëshimi i dokumenteve në bazë të 2 (dy) dëshmitarëve

Certifikatë e varsh-mërisë materiale Mbajtës Familje 25.00€

Vërtetim lajmërim vendbanimit 3.00€

Vertetim i pensioneve jashtë vendi 3.00€

Taksë për dhënien e certifikatës për gjendje ekonomike 1.00€

Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve (DMMP):

Në faqe 10 nenin 15, tabela 21 si më poshtë :

Tabela 21.

1.	Dhënia e lejes mjedisore komunale për vlerën investive te projektit deri në 25. 000 €	50.00€
	Dhënia e Lejës Mjedisore Komunale për vlerën investive të projektit mbi 25. 000 €	paguhet tarifa 0.2% e vlerës investive të projektit

Pjesa tjetër e tabelës të mbetet e njëjtë.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës (DSHPI):

Tabela Nr.6

Nr.	Për bartjen e Automjeteve me Automerimangë	Taksa
a).	Automjetet	18.00€
b)	Mini-bus, xhipat	20.00€
c)	Kamionat)-autobusët	25.00€

1.	Kompenzimi mujor për një vendkalim të automjeteve për operator taxi (radio-taxi) për 5 veturax 20.00€ në muaj për vendparkim që shfrytëzohet	100.00€
2.	Kompenzimi mujor për një vendkalim të automjeteve për operator Taxi individual – në muaj	15.00€
3.	Vazhdimi i vijave, vërtetimit të orarit të nisjeve të rrethave të udhëtimit të udhëtarëve (autobus) në relacione urbane dhe urbane periferike për një vit kalendarik.	100.00€
4.	Operatori Taxi nuk mund të shfrytëzojë më shumë se dy vendkalime të lejuara për automjete.	

Tabela Nr. 7

Nr.	Taksa komunale për qëndrimin e veturave të përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e komunës së veturave - Kategoria	Taksa
1.	Automjetet, motoçikletë dhe traktor – në ditë	1.50€
2.	Mjetet tjera deri në tre tonë e gjysmë (3.5 t) - në ditë	3.00€
3.	Mjetet mbi tre tonë e gjysmë (3.5 t) - në ditë	5.00€

Tabela Nr. 8

Nr.	Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve - Kategoritë	Taksa
A) PARKIM MUJOR		
1.	Për personat juridik në Zonën I – në muaj	30.00€
2.	Për personat fizik në Zonën I – në muaj	20.00€
3.	Për personat juridik në Zonën II – në muaj	25.00€
4.	Për personat fizik në Zonën II – në muaj	15.00€
5.	Për personat juridik në Zonën III – në muaj	20.00€
6.	Për personat fizik në Zonën III	10.00€
7.	Parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave-ne muaj	10.00€
B) PARKIM I PËRKOHSHËM		
	Për personat juridik në Zonën I - në orë	1.00€
	Për personat fizik në Zonën I – në orë;	0.50€
	Për personat juridik në Zonën II – në orë;	0.50€
	Për personat fizik në Zonën II – në orë;	0.50€
	Për personat juridik në Zonën III – në orë	0.30€
	Për personat fizik në Zonën III – në orë	0.20€

Tabela Nr. 9

Nr.	Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare - Kategoria	Taksa
1.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik deri në gjashtë (6) orë	10.00€
2.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	10.00€

3.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë	20.00€
4.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik mbi njëzet e katër orë (24) – për çdo ditë;	20.00€
5.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik deri në gjashtë (6) orë	20.00€
6.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë	20.00€
7.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë	30.00€
8.	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik mbi njëzet e katër ore (24) - për çdo ditë;	30.00€
9.	Bllokimi i pjesshëm i rrugëve sekondare për qëllime të ndërtimit – në ditë	10.00€

Neni 11

Taksat për dëmtimin e rrugëve dhe trotuareve gjatë kryerjes së punëve të ndryshme ndërtimore

Tabela Nr. 10

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Për 1m ² dëmtim të afaltit	30.00€
2.	Për 1 m ² dëmtim të kubëzave të betonit	20.00€
3.	Për 1m ² dëmtim të rrugëve me zhavor	10.00€
4.	Për dëmtim të trotuarit (hapjen e kanaleve në trotuar në m ²)	20.00€
5.	Dëmtim i skajorëve-n metër gjatësi	15.00€
6.	Dëmtim i rigollave 1 metër gjatësi	15.00€
7.	Dëmtim i sipërfaqeve të gjelbërta m ²	10.00€
8.	Dëmtim i rrethojave për mbrojtje të sipërfaqeve të gjelbërta -m ²	25.00€
9.	Dëmtim i shtyllave të ndriçimit publik-copë	200.00€/copë
10.	Për shfrytëzimin e tubacionit në infrastrukturën nëntokësore nga personi i tretë , në projektet e investuara nga komuna,taksa vjetore paguhet për metër gjatësi	0.05€
11.	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë apo trotuar të asfaltuar - gjashtë euro për një metër në katror,dhe investitori e kthen në gjendjen e mëparme.	6.00€/m ²
12.	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë apo trotuar të kubëzuar-katër euro për një metër katror ,dhe investitori e kthen në gjendjen e mëparme.	4.00€/m ²
13.	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë apo trotuar të pa asfaltuar apo pa kubëzuar	2.00€/m ²
14.	Vendosja e kabllave të ndryshme në tokë për qëllime komerciale private – si pagesë e njëhershme vjetore per meter gjatesi	0.30€
15.	Vendosja e kabllave të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – si pagesë e njëhershme vjetore për metër gjatësi	0.05 €
16.	Taksa komunle për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e shtyllave një cop	5.00€/cop
17.	Pëlqimi për kyçje të rrugës anësore në rrugë komunale	20.00€/m ²
18.	Pëlqimi për kyçje ose kryqëzim të rrugës së pakategorizuar me rrugë komunale	10.00€/m ²
19.	Leje për vendosjen e rrethojave mbrojtëse pranë rrugëve komunale	10.00€/m ²

20.	Kushtet teknike të trafikut për projektim e kyqejeve në rrugë komunale si dhe pëlqimin në dokumentacionin teknik të hartuar	1.00€/m ²
21.	Kushtet teknike të trafikut për definim, projektim dhe rregullimin e vendndalimeve për autobusët në rrugët komunale	1.00€/m ²
22.	Kushtet teknike të trafikut për definim, projektim dhe rregullimin e punkteve dhe shtigjeve për biciklist në rrugët komunale	1.00€/m ²
23.	Pëlqimin për dhënjën në shfrytëzim të tokës që i përket brezit të rrugës komunale	10.00€/m ²
24.	Pëlqimi për kyçje të objekteve komerciale në rrugë komunale	20.00€/m ²

Neni 22

Gjobat për mos pagesë të taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. për personin fizik – njëqind euro (100 €);
 - 1.2. për personi fizik që ushtron biznes individual – dyqind euro (200 €); dhe
 - 1.3. për personin juridik – treqind euro (300 €).

Gjobat për mos pagesë të taksës komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve sekondare sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. Personat fizik dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – tridhjetë euro (30 €); dhe
 - 1.2. Personat juridik – njëqind euro (100 €).

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore

1. Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi i pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Personi ndaj të cilit shqiptohet gjobë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik (DFZHE):

Neni 8

Taksat, tarifatat për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Te gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Mitrovicës së Jugut lirohen nga Taksat Komunale, derisa obligimet nga vitet paraprake mbesin për t'u paguar.

Neni 9

Mënyra e caktimit të tarifave për biznese

1. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik do të bëjë shpërndarjen e faturave për obligimet e papaguara aktive më së largu deri më 30.06. për vitin kalendarik.
2. Kundër vendimit/faurës të lëshuar nga ana e Drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, bizneset mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa i drejtohet komisionit prej tre antëaresh i cili do të formohet nga Kryetari i Komunës me propozim të Drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

Andaj, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe bazuar në statusin e komunës së Mitrovicës së Jugut, në propozimet e drejtorive përkatëse, procedurave ekzistuese si dhe të këtij raporti, do të procedojmë tek Komiteti për Politikë dhe Financa si pikë e rendit të ditës për aprovim të propozimeve për ndryshim/plotësim të Rregullorës nr. 02/2019 për Taksat, Tarifatat dhe Gjobat Komunale.

Me respekt,